

LIGJ
Nr. 10 129, datë 11.5.2009
PËR GJENDJEN CIVILE

*(Ndryshuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 1.12.2011;
Ndryshuar me ligjet nr. 6/2012, datë 2.2.2012; nr. 130/2013, datë 25.4.2013; nr. 134/2016, datë
22.12.2016; nr. 69/2018, datë 11.10.2018; nr. 130/2020, datë 22.10.2020 dhe nr. 56/2024, datë
6.6.2024)*

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

(ndryshuar me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

Objekti i këtij ligji është kuptimi dhe përbërësit e gjendjes civile të shtetasve shqiptarë, shtetasve të huaj me leje qëndrimi, shtetasve të huaj që kanë fituar statusin e refugjatit ose mbrojtje plotësuese, si dhe të personave pa shtetësi, me vendbanim ose vendqëndrim në Republikën e Shqipërisë, përcaktimi i rregullave për hedhjen, ruajtjen dhe ndryshimin e tyre, si dhe organizimi e funksionimi i shërbimit të gjendjes civile në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Përkufizime

*(Ndryshuar pika 7 me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013, shtuar fjalë në pikën 2 me ligjin nr.
134/2016, datë 22.12.2016, shtuar fjalë në pikën 7 me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018; ndryshuar pika
1, 2 dhe 4 dhe shtuar pika 9 me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)*

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Gjendja civile” është tërësia e të dhënave personale të shtetasve shqiptarë, shtetasve të huaj me leje qëndrimi, shtetasve të huaj që kanë fituar statusin e refugjatit ose mbrojtjes plotësuese, si dhe të personave pa shtetësi, me vendbanim ose vendqëndrim në Republikën e Shqipërisë, të cilat regjistrohen dhe mbahen në Regjistrin Kombëtar dhe që vërtetojnë lindjen, ekzistencën, individualitetin, lidhjet ose marrëdhëniet ndërmjet tyre.

2. “Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile” në vijim “Regjistri Kombëtar”, është baza e të dhënave shtetërore, ku pasqyrohen dhe përditësohen përbërësit e gjendjes civile të çdo shtetasi shqiptar, shtetasi të huaj me leje qëndrimi, shtetasve të huaj që kanë fituar statusin e refugjatit ose mbrojtjes plotësuese, si dhe të personave pa shtetësi, me vendbanim ose vendqëndrim në Republikën e Shqipërisë.

3. “Regjistri Themeltar i Gjendjes Civile” është libri me fletë të hapur për çdo familje, ku pasqyrohen, për secilin person, të gjithë përbërësit e gjendjes civile. Ky libër ruhet në arkivin e zyrës së arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut.

4. “Përbërës të gjendjes civile” janë të gjitha elementet e përcaktuara në këtë ligj, që shërbejnë për përcaktimin e identitetit të shtetasve shqiptarë, shtetasve të huaj me leje qëndrimi, shtetasve të huaj që kanë fituar statusin e refugjatit ose mbrojtjes plotësuese, si dhe të personave pa shtetësi, me vendbanim ose vendqëndrim në Republikën e Shqipërisë.

5. “Përbërës të prezumuar” janë përbërësit e gjendjes civile, të cilët vlerësohen të mirëqenë deri në çastin, që vërtetohet ndryshe.

6. “Dokumente të arkivuara” është i gjithë dokumentacioni, që mbahet dhe përdoret nga zyra e arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut.

7. “Emra/mbiemra të papërshtatshëm” janë emrat dhe mbiemrat me karakter fytes, imoral ose racist, qesharakë, të vështirë për t’u thirrur, apo që të çojnë në konfuzion, të përcaktuar si të tillë në udhëzim të ministrit, me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.

8. “Ministri”/“Ministria” është ministri/ministria përgjegjëse për shërbimin e gjendjes civile.

9. “Vendbanimi” dhe “Vendqëndrimi”, si përbërës të gjendjes civile, kanë të njëjtin kuptim sipas përcaktimit në Kodin Civil.

Neni 3

Karakteri personal i të dhënave

(Shtuar pika 2/1, ndryshuar pika 3 me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013)

1. Të dhënat, individuale e familjare, të përbërësve të gjendjes civile kanë karakter personal. Aktet, të dhënat dhe konfirmimet shkresore për gjendjen civile i jepen vetëm personit, që i përkasin këto të dhëna, anëtarit të familjes, kujdestarit, përfaqësuesit ligjor ose, me prokurë dhe pas vdekjes, atyre, që kanë legjitimitetin e kërimit të trashëgimisë ligjore ose trashëgimtarëve testamentarë.

2. Të dhënat individuale e familjare të përbërësve të gjendjes civile mund të kërkojnë dhe të merren nga institucionet e organet, të cilave kjo e drejtë u njihet me ligj të veçantë. Këto subjekte, që kërkojnë dhe marrin të dhëna të gjendjes civile, drejtpërdrejt nga shërbimi i gjendjes civile, i përdorin ato vetëm për qëllimin për të cilin janë marrë, duke u rezervuar në përhapjen e tyre, përveçse kur autorizohen me ligj.

2/1. Çdo institucion, organ, person juridik apo fizik, privat apo shtetëror, që nuk përfshihet në pikën 2 të këtij neni, mund të kërkojë dhe të marrë të dhënat e gjendjes civile të një personi, vetëm nëse merr pëlqimin me shkrim nga ana e personit, subjekt i të dhënave. Në këtë rast, të dhënat e gjendjes civile përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë marrë dhe për të cilin ka dhënë pëlqimin me shkrim personi, subjekt i të dhënave.

3. Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile autorizon dhënien e të dhënave të kërkuara prej subjekteve të treta, sipas pikave 2 dhe 2/1 të këtij neni, sipas procedurës të parashikuar me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për gjendjen civile dhe Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në këtë udhëzim përcaktohen lloji, mënyra e dhënies dhe sasia e informacionit, që mund t’u jepet subjekteve kërkuuese, në bazë të legjislacionit që rregullon organizimin dhe funksionimin e tyre apo pëlqimin me shkrim të dhënë nga personi, subjekt i të dhënave, duke respektuar legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 4

Vlera juridike e të dhënave

(ndryshuar neni me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

1. Të dhënat e gjendjes civile janë të vlefshme kur lëshohen nga nëpunës të shërbimit të gjendjes civile ose kur lëshohen me mjete elektronike, në mënyrën dhe formën e parashikuar në këtë ligj dhe në aktet nënligjore, të dala në zbatim të tij.

2. Për çdo dokument fizik që u jepet shtetasve, institucioneve dhe organeve të autorizuar me ligj, nëpunësi i zyrës së gjendjes civile shënon në mënyrë të plotë emrin, mbiemrin, nënshkrimin e vet dhe përdor vulën zyrtare të shërbimit të gjendjes civile.

3. Çdo dokument elektronik, që u jepet shtetasve, institucioneve dhe organeve të autorizuar me ligj, përmban nënshkrimin elektronik të nëpunësit që e lëshon. Dokumentet elektronike që postohen nga Regjistri Kombëtar, në sesionin “Dokumentet e mia”, në portalin unik qeveritar “e-Albania”, përmbajnë vulën elektronike të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.

Neni 5

Papajtueshmëria e veprimeve

Nëpunësi i gjendjes civile nuk mund të kryejë veprime të gjendjes civile aty ku është emëruar, kur këto i përkasin atij vetë, bashkëshortit e fëmijëve të tij, prindërve, gjyshit, gjyshes, vëllezërve, motrave, vjehrrit ose vjehrrës. Në këtë rast veprimet kryhen nga një nëpunës tjetër i shërbimit të gjendjes civile.

KREU II

GJENDJA CIVILE

Neni 6

Përbërësit dhe veçoritë e gjendjes civile të shtetasve

(Shfuqizuar termi “kombësi” me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 1.12.2011)

1. Përbërësit e gjendjes civile janë: emri e mbiemri, numri personal, datëlindja, vendlindja, gjinia, shtetësia, raportet e atësisë e amësisë, gjendja civile, vdekja, shpallja i/e zhdukur, vendbanimi, vendqëndrimi dhe fakte të tjera, të parashikuara me ligj.

2. Shtetësia shqiptare, si përbërës i gjendjes civile, është elementi i vetëm dallues nga shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi.

3. Elementet përbërëse në dokumentet e shërbimit të gjendjes civile kanë përparësi ndaj të njëjtave elemente të çdo akti tjetër, shtetëror ose privat dhe janë të detyrueshme të respektohen.

Neni 7

Numri personal

1. Numri personal është numri unik i papërsëritshëm, që i caktohet çdo shtetasi shqiptar, shtetasi të huaj, si dhe çdo personi pa shtetësi, me qëndrim të përkohshëm/të përhershëm, me lidhje të caktuara ekonomike nga shërbimi gjendjes civile.

2. Mënyra e formimit të këtij numri përcaktohet me ligj të veçantë.

Neni 8

Veçoritë e disa përbërësve të gjendjes civile

(Shfuqizuar termi “kombësi” me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 1.12.2011)

Lindja, gjinia, emri e mbiemri, raportet e atësisë, amësisë dhe shtetësia njihen e mund të hiqen, të shuhën, të ndryshojnë ose t’u kalojnë të tjerëve vetëm në rastet e në mënyrën e përcaktuar shprehimisht në këtë ligj apo në çdo ligj tjetër të veçantë.

Neni 9

Përbërës të rrjedhur nga ngjarje natyrore

Lindja, koha e lindjes, gjinia, amësia dhe vdekja vërtetohen rregullisht, si fakte juridike, nga personat dhe organet, të cilëve u njihet ky tagër, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 10

**Përbërës të prezumuar ose të rrjedhur
nga veprimet e vetë personit**

Fakte juridike të prezumuara me ligj ose të rrjedhura nga veprimet e vetë personit, që vërtetohen, janë raportet e atësisë, amësisë dhe familja.

Neni 11

Përbërës të rrjedhur nga aktet e organeve të tjera
(shtuar fjalë me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

Birësimi, shtetësia, ushtrimi i përgjegjësisë prindërore, heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, si përbërës kryesorë të gjendjes civile, burojnë dhe pasqyrohen vetëm në mbështetje e në përputhje me aktin e organit përgjegjës shtetëror, sipas ligjit. Prej tyre përcaktohen edhe përbërësit e tjerë kryesorë të gjendjes civile, kur ndryshohen sipas ligjit.

Neni 12

Përbërës që vërtetohen nga burime të tjera

Përbërësit e tjerë vërtetohen sipas ligjit nga organet dhe institucionet shtetërore, subjektet juridike, shtetërore e private, ose drejtpërdrejt nga ligji i veçantë dhe marrin cilësinë e përbërësit, kur pasqyrohen në dokumentet e gjendjes civile.

Neni 13

(ndryshuar me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

Gjendja civile e një personi mund të jetë:

- a) “beqar/e”, shtetasi, i cili nuk ka lidhur akt martese;
- b) “i/e martuar”, shtetasi, i cili është lidhur me akt martese;
- c) “i/e ve”, shtetasi, të cilit i ka vdekur bashkëshorti/ja, me të cilin ishte i/e lidhur me akt martese;
- ç) “i/e divorcuar”, shtetasi, martesa e të cilit është zgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë

KREU III

DEKLARIMI DHE REGJISTRIMI I VENDBANIMIT

Neni 14

Deklarimi dhe ndryshimi i vendbanimit ose vendqëndrimit

(shtuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016; ndryshuar neni me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

1. Shtetasit kanë detyrimin që të deklarojnë adresën e vendbanimit dhe vendqëndrimit brenda vendit, si dhe ndryshimin e tyre, sipas të gjitha elementeve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për sistemin e adresave.

2. Institucionet shëndetësore dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale bëjnë deklarinë e vendqëndrimit të shtetasve, qëndrimi i të cilëve në këto institucione zgjat më shumë se 3 (tre) muaj, brenda 48 (dyzet e tetë) orëve nga data e përmbushjes së afatit.

3. Regjistrimi i vendbanimit dhe vendqëndrimit kryhet nga zyra e gjendjes civile në njësinë administrative, që ka në juridiksion territorial vendbanimin ose vendqëndrimin, pas marrjes së kërkesës nga shtetasi. Shtetasi nuk mund të deklarojë më shumë se një vendbanim ose një vendqëndrim njëherazi.

4. Ndryshimi i vendbanimit ose vendqëndrimit kryhet nga zyra e gjendjes civile të njësisë administrative që ka në juridiksion territorial vendbanimin ose vendqëndrimin e ri, pas marrjes së kërkesës nga shtetasi. Shtetasi duhet të deklarojë vendbanimin ose vendqëndrimin e ri jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga zhvendosja në këtë vendbanim ose vendqëndrim.

5. Një ose më shumë familje kanë të drejtë të banojnë në vendbanimin e një familjeje tjetër vetëm kur plotësohen standardet për sipërfaqen minimale të banimit që duhet të ketë një individ në banesë, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

6. Nëpunësi i gjendjes civile, në mbështetje të dokumentacionit zyrtar të lëshuar nga autoritetet përgjegjëse ku përcaktohet sipërfaqja e banesës, kryen verifikimin nëse përmbushet standardi i sipërfaqes minimale të banimit, sipas pikës 5 të këtij neni.

7. Mënyra e paraqitjes së kërkesës, dokumentacionit të nevojshëm, rregullat për deklarimin dhe ndryshimin e vendbanimit ose vendqëndrimit të shtetasve dhe institucioneve shtetërore, të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

8. Shtetasit, që kërkojnë të kryejnë veprime në regjistrin e gjendjes civile, duhet të kenë përmbushur detyrimin për deklarimin e ndryshimit të vendbanimit ose vendqëndrimit.

Neni 15

(shfuqizuar me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

Neni 16

E drejta për deklarimin e vendbanimit

1. Deklarimin e vendbanimit apo të banesës për pjesëtarët e një familjeje ka të drejtë ta bëjë kryefamiljari ose, në pamundësi të tij, çdo person madhor i familjes.

2. Çdo person madhor, që vendos të jetojë në një vendbanim të ndryshëm nga ai i pjesëtareve të tjerë të familjes, bën deklarim individual të vendbanimit. Shtetasi mund të deklarojë, gjithashtu, në mënyrë individuale një banesë për përdorim vetjak.

3. Shtetasi i mitur, apo që i është hequr zotësia për të vepruar, ka vendbanim të njëjtë, sipas rastit, me atë të kryefamiljarit, prindit me të cilin jeton apo të kujdestarit të tij. Kur një i mitur apo një person, të cilit i është hequr zotësia për të vepruar, banon në një vendbanim të ndryshëm nga prindërit e tij, deklarimi për të, bëhet sipas rastit, nga kryefamiljari, njëri nga prindërit, apo personi që zotëron kujdestarinë. Në këtë rast zyra e gjendjes civile administron edhe dokumentacionin që provon kujdestarinë mbi të miturin dhe vendbanimin e kujdestarit.

Neni 17

(shfuqizuar me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

Neni 18

Vendbanimi në institucionet e vuajtjes së dënimit dhe të kurimit mjekësor afatgjatë për qëllime zgjedhore

(ndryshuar neni me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

1. Për shtetasit që kryejnë dënimin në institucionet e vuajtjes së dënimit apo janë vendosur në institucionet e paraburgimit ose shtetasit që qëndrojnë pa ndërprerje në institucione shëndetësore për kurim afatgjatë dhe që përfshin qëndrimin e tyre në to edhe datën e zgjedhjeve, vendbanim për qëllime të zbatimit të legjislacionit për zgjedhjet konsiderohet adresa e institucionit përkatës.

2. Institucionet përkatëse jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve njoftojnë Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile për shtetasit që qëndrojnë në këto institucione në përputhje me pikën 1 të këtij neni. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nëpërmjet zyrave përkatëse të gjendjes civile dhe sipas përcaktimeve të ligjit për zgjedhjet harton dhe printon listat e zgjedhësve për këta shtetas që deri në datën e zgjedhjeve ndodhen në këto institucione. Këtyre shtetasve iu mundësohet votimi në qendrën e votimit të krijuar, sipas ligjit zgjedhor në këto institucione. Lista e zgjedhësve e hartuar sipas këtij neni është e vlefshme vetëm për zgjedhjet e radhës dhe ripërsëritet sipas të njëjtave modalitete për çdo zgjedhje.

3. Ministri përgjegjës për gjendjen civile dhe ministri i Drejtësisë përcaktojnë me udhëzim të përbashkët rregullat e njoftimit dhe bashkëpunimit të institucioneve për këta shtetas, procedurën e çregjistrimit dhe regjistrimit të gjendjes civile të vendbanimit për qëllime zgjedhore sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen.

Neni 19

(shfuqizuar me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

Neni 20

(shfuqizuar me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

Neni 21

Regjistrimi i vendqëndrimit të shtetasve të huaj me leje qëndrimi, shtetasve të huaj që kanë fituar statusin e refugjatit ose mbrojtjes plotësuese, si dhe të personave pa shtetësi

(ndryshuar neni me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

1. Regjistrimi dhe ndryshimi i vendqëndrimit të shtetasve të huaj me leje qëndrimi dhe të personave pa shtetësi, me vendqëndrim në Republikën e Shqipërisë, kryhet sipas rregullave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për të huajt.

2. Regjistrimi dhe ndryshimi i vendqëndrimit të shtetasve të huaj, që kanë fituar statusin e refugjatit ose mbrojtjes plotësuese, kryhet sipas rregullave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për azilin.

Neni 21/1

Deklarimi dhe regjistrimi i adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

(shtuar me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

Deklarimi dhe regjistrimi i adresës së shtetasve shqiptarë, të cilët jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, bëhet sipas legjislacionit në fuqi për regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 22

(shfuqizuar me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

Neni 23

Veprimet për fitimin dhe lënien e shtetësisë shqiptare

(ndryshuar me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

1. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile përcjell në zyrën e gjendjes civile, ku do të regjistrohet shtetasi, dekretin e Presidentit të Republikës për fitimin e shtetësisë shqiptare. Në këtë rast, zyra e gjendjes civile, në momentin e paraqitjes së shtetasit, cakton datën dhe orën e kryerjes së betimit.

2. Në rastin e dekretit të Presidentit të Republikës për lënien e shtetësisë shqiptare, zyra e gjendjes civile, ku shtetasi rezulton i regjistruar, kryen veprimet për çregjistrimin e tij nga Regjistri Kombëtar brenda 30 ditëve, nga marrja e dekretit. Kopje e këtij dekreti i përcillet Ministrisë së Punëve të Jashtme nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

3. Rregullat, procedurat për kryerjen e betimit dhe teksti i betimit përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për shërbimin e gjendjes civile.

Neni 24

E drejta e DPGJC-së të mbledhë të dhëna nga institucione të treta

1. DPGJC-ja ka të drejtë të ketë akses ose të kërkojë informacion, në mënyrë periodike apo rast pas rasti, nga institucione ose ente shtetërore e private të tjera që mbledhin dhe administrojnë baza të dhënash të shtetasve që përmbajnë të dhëna lidhur me adresën e personit apo të vendbanimit të tij.

2. Institucionet dhe entet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni janë të detyruara që t'i sigurojnë akses të menjëhershëm e të papenguar DPGJC-së në bazat përkatëse të të dhënave, ose t'i dërgojnë asaj informacionin e kërkuar jo më vonë se 10 ditë nga marrja e kërkesës.

3. DPGJC-ja i përdor të dhënat e siguruar në zbatim të këtij neni, për aq sa është e nevojshme për të verifikuar dhe siguruar saktësinë e të dhënave të Regjistrit Kombëtar. Të dhënat e siguruar nga baza alternative të dhënash nuk përbëjnë burim të drejtpërdrejtë dhe të vetëm të dhënash, në lidhje me përbërësit e gjendjes civile të shtetasve. DPGJC-ja i përdor të dhënat në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale të shtetasve.

4. Këshilli i Ministrave përcakton llojin, sasinë, organizimin e informacionit dhe rregullat për marrjen dhe përpunimin e informacionit, sipas këtij neni.

KREU IV

NATYRA DHE DOKUMENTIMI I PËRBËRËSVE TË GJENDJES CIVILE

Neni 25

Llojet dhe veçoritë e përgjithshme të dokumenteve

(Shfuqizuar shkronja "b" e pikës 3 me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013; ndryshuar togfjalësh në pikën 1 dhe shkronja "dh", shtuar togfjalësh në pikën 2 dhe shkronja "ë", shfuqizuar shkronja "a" e pikës 3 me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

1. Përbërësit e gjendjes civile të shtetasve shqiptarë, të shtetasve të huaj dhe të personave pa shtetësi, me banim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, vërtetohen e dokumentohen në dokumentet bazë të gjendjes civile.

Këto dokumente hartohen nga shërbimi i gjendjes civile, në bazë të veprimeve të kryera nga nëpunësit e këtij shërbimi ose dokumentet bazë, të ardhura nga të tretët, në formë fizike ose elektronike, sipas ligjit në fuqi.

2. Dokumentet bazë, që mban, harton dhe administron shërbimi i gjendjes civile, janë:

- a) akti i lindjes;
- b) akti i martesës;
- c) akti i vdekjes;
- ç) regjistrat themeltarë;
- d) Regjistri Kombëtar;
- dh) vendimet e komisionit kombëtar për ndryshimin e emrit dhe mbiemrit;
- e) procesverbali/procesverbalet për bashkim dhe veçim familjar.
- ë) vendimet për korrigjimin e gabimit material të drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes

Civile.

3. Dokumentet bazë, që lëshon zyra e gjendjes civile, janë:

- a) shfuqizuar;
- b) shfuqizuar;
- c) certifikata e lindjes;
- ç) certifikata martesore;
- d) certifikata e familjare;
- dh) certifikata e vdekjes.

4. Forma, elementet përbërëse, mënyra e mbajtjes, afati i përdorimit të dokumenteve bazë, që mbahen dhe lëshohen nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe rregullat e lëshimit të këtyre dokumenteve përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 26

Letërnjoftimi

1. Dokumenti bazë i përhershëm për identifikimin e shtetasve është letërnjoftimi.

2. Personat, të cilët, për efekt moshe, sipas ligjit, nuk përfitojnë letërnjoftim, pajisen nga zyra e gjendjes civile me certifikatën e lindjes me fotografi, sipas rregullave të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

Neni 27

Aktet për lindjet, martesat e vdekjet

(ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016 dhe me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

1. Aktet e lindjes, të martesës dhe të vdekjes plotësohen e pasqyrohen në akte të veçanta, në formë elektronike dhe të printuara vetëm nga nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile, pasi ka administruar, drejtpërdrejt, dokumentet bazë ose ka pranuar personalisht deklaratimet për faktin e lindjes, lidhjen e martesës ose vdekjen, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Këto akte mbahen, për çdo rast, të renditura kronologjikisht.

2. Aktet e lindjes, të martesës dhe të vdekjes për shtetasit e huaj dhe personave pa shtetësi, me banim të përhershëm në Shqipëri, mbahen në zyrën e gjendjes civile në bashki/njësi administrative ku ato janë të regjistruar ose ku ka ndodhur lindja apo vdekja. Këto akte mbahen nga përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile dhe pasqyrohen në Regjistrin Kombëtar.

3. Aktet e lindjes, të martesës dhe të vdekjes, për shtetasit shqiptarë, për shtetasit e huaj dhe ata pa shtetësi, me banim të përhershëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, të mbajtura nga shërbimi i gjendjes civile i shteteve të huaja ose nga misionet diplomatike dhe postet konsullore atje, përcillen në zyrat e gjendjes civile përkatëse për vazhdimin e mëtejshëm të procedurës, nga vetë i interesuari ose nëpërmjet ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile.

Neni 28

Nënshkrimi i akteve

1. Nëpunësi i gjendjes civile, i interesuari, si dhe të pranishmit, kur parashikohet nga ky ligj, nënshkruajnë me të njëjtin mjet, si dhe shënojnë emrin e mbiemrin. Nënshkrimi i nëpunësit të gjendjes civile, në çdo rast, shoqërohet me vulën e zyrës së gjendjes civile, në të kundërt veprimi është i pavlefshëm.

2. Kur personi nuk di ose nuk është në gjendje fizike të nënshkruajë, në akt shënohen shkaqet, të vërtetuara me nënshkrim të veçantë të përgjegjësit të zyrës së gjendjes civile, të nëpunësit dhe të pjesëmarrësve të tjerë, të pranishëm në veprim.

Neni 29

Dokumentet e tjera bazë

(Shtuar pika 3 me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013)

1. Dokumente të tjera janë aktet zyrtare, shtetërore ose joshtetërore, të cilat, sipas ligjit, vërtetojnë ose ndryshojnë faktet juridike, të vërtetuara me aktet e gjendjes civile. Përmbajtja e tyre, kur pasqyrohet në Regjistrin Kombëtar, shndërrohet në përbërës të gjendjes civile të shtetasit.

2. Dokumentet e tjera bazë, si dhe i gjithë dokumentacioni tjetër, me karakter administrativ, plotësohen e administrohen, në përputhje me kriteret ligjore përkatëse, sipas llojit të dokumentit.

3. Përmbajtja e fletës familjare të regjistrit themeltar është e pavlefshme kur përbërësi i përket periudhës para krijimit të regjistrit dhe nuk ka dorëshkrimin e plotësuesit të parë të asaj flete ose, pavarësisht nga periudha që i përket, nuk mbështetet në një libër aktesh apo dokumentesh bazë, të pasqyruar si burim edhe në faqen përkatëse të fletës familjare.

Neni 30

Korrigjimet dhe plotësimet në dokumentet e arkivuara

(Shfuqizuar me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013)

Neni 31

Detyrimet e organeve të tjera

Të gjitha organet, të cilat, në mbështetje të këtij ligji apo sipas një ligji të veçantë, janë përgjegjëse për caktimin, vërtetimin ose ndryshimin e një përbërësi të gjendjes civile, detyrohen të dërgojnë, zyrtarisht e drejtpërdrejt, një kopje të aktit, vendimit, në zyrën e gjendjes civile, ku personi figuron i regjistruar, brenda 15 ditëve nga data e lëshimit të aktit ose nga marrja e formës së prerë të vendimit.

Neni 32

Administrimi i dokumentacionit

(shtuar pika 3/1 me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016; hequr togfjalësh në pikën 1 me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

1. Aktet mbyllen më 31 dhjetor të çdo viti. Përgjegjësi i gjendjes civile në degën e qarkut rishikon saktësinë e veprimeve të kryera në aktet e lindjeve, të martesave e të vdekjeve dhe, në bashkëpunim me nëpunësin përkatës të zyrës së gjendjes civile, bën mbylljen e tyre. Pas verifikimit, aktet dorëzohen në arkivin e zyrave të arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut, jo më vonë se data 20 janar e vitit pasardhës dhe ruhen përgjithmonë.

2. Dokumentet, mbi të cilat bazohet formulimi i akteve të gjendjes civile, vendosen në arkivin e zyrës së gjendjes civile, në njësinë e qeverisjes vendore, në muajin e parë të vitit pasardhës dhe ruhen për një periudhë 10-vjeçare.

3 Me krijimin e Regjistrit Kombëtar, regjistrat themeltarë të shtetasve në bashki/njësi administrative dorëzohen në arkivin e zyrave të arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut, sipas procedurave të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

3/1. Për kryerjen e veprimeve, zyrat e gjendjes civile pranojnë vetëm akte ose dokumente origjinale.

4. Për administrimin e të gjithë dokumentacionit, shërbimi i gjendjes civile zbaton rregullat e përgjithshme për arkivat, për sa nuk parashikohet dhe nuk bie në kundërshtim me këtë ligj.

KREU V
REGJISTRI KOMBËTAR

Neni 33

Regjistri Kombëtar

(Ndryshuar pika 4 me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.201, ndryshuar pika 1 dhe shtuar pika 1/1 me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016, ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018; shfuqizuar pikat 1 dhe 4 me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

1. Shfuqizuar.

1/1. Në Regjistrin Kombëtar transkriptohen të dhënat për shtetasit shqiptarë sipas akteve të zyrave të gjendjes civile të vendeve të huaja. Pasqyrimi i këtyre akteve bëhet kronologjikisht, në përputhje me legjislacionin në fuqi, pasi nga nëpunësi i zyrës së gjendjes civile janë kryer verifikimet e nevojshme për përputhshmërinë e të dhënave në dokumentacionin e administruar me ato të shërbimit të gjendjes civile.

2. Regjistri Kombëtar administrohet nga institucioni përgjegjës i përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Veprimet në Regjistrin Kombëtar dhe në aktet e gjendjes civile bëhen me anë të teknikave informatike.

4. Shfuqizuar.

Neni 34

Veprimet në Regjistrin Kombëtar

(hequr fjalë me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

Veprimet në Regjistrin Kombëtar kryhen vetëm nga nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile në njësi administrative dhe nga nëpunësi në misionet diplomatike dhe postet konsullore, pasi ka administruar, drejtpërdrejt, dokumentet bazë, në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

Neni 35

Regjistrimi në Regjistrin Kombëtar

(ndryshuar neni me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

1. Në Regjistrin Kombëtar, në seksionin e të dhënave personale, pasqyrohen përbërësit e gjendjes civile të çdo shtetasi të përcaktuar në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji.

2. Rregullat e regjistrimit, të dhënat parësore, të dhënat dytësore, dhënësit e informacionit, ndërveprimi me bazat e tjera të të dhënave dhe niveli i aksesimit për bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 36

Plotësimet dhe korrigjimet në Regjistrin Kombëtar

(ndryshuar titulli dhe shtuar një paragraf në fund të shkronjës "c" me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

Kur në Regjistrin Kombëtar vërehen gabime materiale ose gjendet rubrikë, që nuk pasqyron përbërësin përkatës, përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile bën korrigjimin ose plotësimin, kur:

a) përbërësi figuron në librat e akteve, në regjistrat themeltarë të mëparshëm të asaj zyre ose të vendit prej nga ka ardhur, me ndryshim të vendbanimit, për çdo shkak;

b) i interesuari paraqet dokumentin bazë nga burimi përgjegjës, sipas ligjit;

c) vërtetohet, në të gjitha rastet e tjera, me vendim gjykate.

Për korrigjimin si gabim të provuar material të rubrikës së emrit, mbiemrit, emrit të babait, emrit të nënës, ndiqet procedura e parashikuar në nenin 57/7 e vijues të këtij ligji.

Neni 37

Mungesa e së dhënës

1. Kur e dhëna, që kërkohet për aktin e lindjes dhe të vdekjes, është e pamjaftueshme ose nuk vërtetohet nga deklaruesi, verifikohet pjesa përkatëse pranë organit, që ka dijeni për faktin juridik, përveç rasteve të shënimeve të përkohshme, sipas këtij ligji.

2. Me vërtetimin e së dhënës apo caktimin përfundimtar, bëhet plotësimi vetëm në Regjistrin Kombëtar.

KREU VI

REGJISTRIMI I AKTIT TË LINDJES

Neni 38

Dokumentet bazë të lindjes

1. Lindjet si fakt, kohë, vend, gjinia dhe amësia vërtetohen me certifikatën e asistencës së lindjes, me raport mjekësor ose procesverbal, të hartuar në kohën e lindjes, i cili vërtetohet nga personeli mjekësor i pranishëm, si dhe përgjegjësi i trenit, kapiteni i anijes ose i avionit në udhëtim, drejtuesi i burgut ose i repartit ushtarak, organi i rendit publik, apo zyrtarë të misioneve diplomatike dhe posteve konsullore, në mungesë të personelit mjekësor.

2. Në mungesë të dokumentacionit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, vërtetimi i faktit të lindjes mund të provohet edhe nëpërmjet gjykatës.

3. Dokumentet e mësipërme shërbejnë për plotësimin e aktit të lindjes.

Neni 38/1

Akti i lindjes i lëshuar jashtë vendit

(shtuar me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

1. Në rastet kur akti i lindjes i lëshuar në një shtet tjetër ka të dhëna të paplota ose të pasakta, gjykata bën vërtetimin e faktit juridik të lindjes, me qëllim regjistrimin në zyrat e gjendjes civile.

2. Kërkesën për vërtetimin e faktit juridik të lindjes mund ta paraqesin subjektet e parashikuara në nenin 40 të këtij ligji.

3. Kërkesa shqyrtohet nga gjykata e rrethit gjyqësor, në të cilin kanë vendbanimin prindi ose prindërit e fëmijës për të cilin kërkohet regjistrimi.

4. Gjkata që shqyrton çështjen për vërtetimin e faktit juridik të lindjes, merr vendim brenda 45 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës, duke thirrur, me cilësinë e personit të interesuar, zyrën e gjendjes civile.

5. Nëse ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë ushtrohet ankim, gjykata e apelit shqyrton ankimin, në dhomë këshillimi, brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të tij.

Neni 39

Dokumentet bazë të personave të gjetur

1. Fëmija me prindër të panjohur prezumohet i lindur në vendin ku është gjetur dhe në kohën që përcaktohet me raport mjekësor.

2. Fëmija me prindër të panjohur pajiset me procesverbal nga organet përkatëse të rendit publik dhe raport mjekësor, të lëshuar nga mjeku i zonës ku është gjetur.

3. Me kërkesë të shërbimit të gjendjes civile ose, kryesisht, me miratimin e kryetarit të

bashkisë/ njësisë administrative, ku është gjetur fëmija, atij i caktohet emri e mbiemri, si dhe emra prindërisht imagjinare, që mund të ndryshojnë me kërkesë të vetë fëmijës, kur bëhet madhor, ose me vërtetimin ligjor të prindërve.

4. Rregullat e mësipërme vlejnë edhe për fëmijët me prindër të panjohur, që kanë humbur kujtesën ose janë të paaftë mendërisht dhe që nuk identifikohen. Fëmijës së gjetur mund t'i ndryshojë kjo gjendje, në rastet kur i kthehet kujtesa, kur shërohet mendërisht ose identifikohet me një mënyrë tjetër.

5. Në të gjitha rastet e parashikuara në këtë nen, fëmija i gjetur regjistrohet në vendin, ku vendoset për jetesë, me përjashtim të të gjeturit madhor, që flet vetëm gjuhë të huaj e që regjistrohet si person pa shtetësi.

6. Kriteret e përcaktuara në këtë nen zbatohen edhe për personin madhor, që ka humbur kujtesën, që është i paaftë mendërisht e që nuk i dihen prindërit, është gjetur me prindër të vdekur, të paidentifikuar, përveç rastit, kur ky person flet vetëm gjuhë të huaj. Në këtë rast ai trajtohet si person pa shtetësi.

Neni 40

Deklarimi i lindjes

(shtuar fjalë në pikën 2 dhe shtuar pika 3 me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

1. Lindja e fëmijës deklarohet te nëpunësi i gjendjes civile nga prindërit, pjesëtarët madhorë të familjes, përfaqësuesit ligjorë ose kujdestarët, dhe, në pamundësi ose në mungesë të tyre, nga personat, që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen. Deklarimi mund të bëhet edhe nga përfaqësues të nënës, me prokurë të posaçme.

2. Deklarimi i lindjes së fëmijës së gjetur, të cilit nuk i dihen prindërit, bëhet nga organet e njësisë së qeverisjes vendore, njësitë për mbrojtjen e fëmijës, organi i rendit publik, në juridiksionin e të cilit ndodhet vendi i gjetjes, në bazë të procesverbalit të mbajtur në kohën e gjetjes së fëmijës.

3. Nëse deklarimi i lindjes së fëmijës nuk kryhet brenda 60 ditëve nga lindja, nga personat e përcaktuar në pikën 1, deklarimi kryhet nga subjektet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni. Rregulla të hollësishme për zbatimin e kësaj dispozite përcaktohen me akt nënligjor të ministrit përgjegjës për gjendjen civile.

Neni 41

Regjistrimi i lindjes

(shfuqizuar pika 3 dhe ndryshuar pika 5 me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016, shtuar pika 3 dhe shfuqizuar pika 6 me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

1. Regjistrimi i lindjes së fëmijës bëhet në zyrën e gjendjes civile të vendbanimit të prindërve ose në vendin ku ka ndodhur lindja.

2. Për fëmijën e gjetur, të cilit nuk i dihen prindërit, regjistrimi bëhet në zyrën e gjendjes civile të vendit ku është gjetur.

3. Për fëmijët e lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga shtetas shqiptarë me banim të përhershëm në Shqipëri, regjistrimi i lindjes së fëmijës bëhet në shërbimin e gjendjes civile të atij vendi. Kur kjo është e pamundur, regjistrimi i lindjes mund të bëhet edhe në misionet diplomatike ose postet konsullore shqiptare në vendin ku ka ndodhur lindja.

4. Kur regjistrimi i lindjeve kryhet brenda 60 ditëve, për lindjen brenda vendit dhe brenda 90 ditëve, për lindjen jashtë vendit, nëna përfiton shpërblim në masën 5 000 (pesë mijë) lekë.

5. Fondi për shpërblimin për regjistrimin e lindjes brenda afatit, sipas përcaktimit të bërë në pikën 4, të këtij neni, përballohet nga Buxheti i Shtetit. Procedurat për përfitimin e shpërblimit

përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për shërbimin e gjendjes civile.

6. Shfuqizuar.

7. Njësitë operative të policisë në terren, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, konstatojnë dhe konfirmojnë, në rrugë zyrtare, rastet e lindjeve dhe regjistrimin e tyre nga personat e parashikuar në pikën 2 të nenit 40 të këtij ligji, në zonën që mbulojnë.

Neni 41/1

Raportimi dhe regjistrimi i lindjeve me procedurë të veçantë

(shtuar me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

1. Të gjitha subjektet shëndetësore, shtetërore, publike dhe private, që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen, janë të detyruara që, për çdo lindje të ndodhur pranë institucioneve të tyre, të dërgojnë në zyrat e gjendjes civile, ku prindërit kanë vendbanimin, dokumentacionin/njoftimet përkatëse. Ky proces kryhet çdo ditë të hënë, për javën pararendëse.

Modalitetet, lloji i dokumentacionit, forma dhe mënyra e komunikimit ndërmjet këtyre institucioneve përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrave përkatës që mbulojnë institucionet e lartpërmendura.

2. Për çdo lindje të raportuar, sipas pikës 1, të këtij neni, zyra përkatëse e gjendjes civile pasqyron lindjen në regjistrin e përkohshëm.

Ministri përgjegjës për gjendjen civile përcakton me udhëzim rregulla të hollësishme për krijimin dhe administrimin e regjistrit të përkohshëm të lindjeve të raportuara.

3. Nëse regjistrimi i lindjes së fëmijës nuk kryhet brenda 60 ditëve nga data e lindjes, nëpunësi i gjendjes civile informon njësinë për mbrojtjen e fëmijës, pranë njësisë vendore, e cila ndërmerr veprimet konkrete për vlerësimin e situatës dhe regjistrimin e lindjes në zyrën e gjendjes civile.

Rregulla të hollësishme për zbatimin e kësaj dispozite përcaktohen me akt nënligjor të ministrit përgjegjës për gjendjen civile.

Neni 42

Akti i lindjes

(Shfuqizuar termi “kombësi” në shkronjën “e” me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 1.12.2011)

1. Akti i lindjes vërteton ligjërisht lindjen e shtetasit.

2. Akti i lindjes është procesverbal, që mbahet për çdo të lindur, i nënshkruar nga nëpunësi i gjendjes civile në bashki/njësi administrative dhe deklaruesi.

Ai përmban:

a) numrin rendor, datën e mbajtjes dhe zyrën e gjendjes civile;

b) datën e plotë dhe orën e lindjes;

c) vendin e lindjes;

ç) emrin e mbiemrin, të caktuar sipas dispozitave ligjore në fuqi;

d) numrin personal të fëmijës;

dh) gjininë;

e) Shfuqizuar.

ë) shtetësinë;

f) faktin nëse ka lindur normal, binjak apo siamez;

g) numrin personal dhe identitetin e nënës;

gj) numrin personal dhe identitetin e babait, kur njihet, sipas dispozitave ligjore në fuqi;

h) identitetin, numrin personal dhe cilësinë e deklaruesit;

i) numrin personal, emrin dhe mbiemrin e përkthyesit.

Neni 43

Vlefshmëria dhe kundërshtimi i aktit të lindjes

1. Akti i lindjes është absolutisht i pavlefshëm, kur nuk është mbajtur nga nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile, ose kur nuk është nënshkruar qoftë edhe nga njëri prej personave të parashikuar në pikën 2 të nenit 42 të këtij ligji. Në raste të tjera, akti i lindjes është i relativisht i pavlefshëm.

2. Nuk mund të konfirmohet përmbajtje tjetër nga ajo e aktit të lindjes pa u vërtetuar pavlefshmëria absolute ose relative, pasaktësia ose falsiteti i pretenduar për aktin përkatës.

3. Shtetasi, përfaqësuesi ligjor ose kujdestari, si dhe çdo person tjetër, që pretendon se i është cenuar një e drejtë ose është privuar nga pasoja juridike të caktuara, pretendimet për pavlefshmëri, pasaktësi e falsitet mund t'i parashtrojnë vetëm gjyqësisht, duke thirrur si të paditur zyrën e gjendjes civile.

4. Njohja ose kundërshtimi i atësisë e i amësisë bëhen sipas kriterëve të përcaktuara në Kodin e Familjes.

Neni 44

Ndryshimi i të dhënës së aktit të lindjes

(Ndryshuar me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013)

Përmbajtja e aktit të lindjes, e pasqyruar në Regjistrin Kombëtar, mund të ndryshohet vetëm në rastet e përcaktuara shprehimisht në këtë ligj.

Neni 45

Plotësimi i të dhënave të aktit të lindjes

(shtuar pika 3/a me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

1. Në Regjistrin Kombëtar pasqyrohen të dhënat sikurse janë e për aq sa përmban akti i lindjes, shoqëruar me shënimin për të dhënat e përkohshme.

2. Kur në aktin e lindjes është caktuar emri i përkohshëm, mund të bëhet shënimi, në çdo kohë, kundrejt deklaramit e nënshkrimit të përbashkët të prindërve ose me vendim gjykate. Kur fëmija bëhet madhor, kjo e drejtë mund të ushtrohet vetëm prej tij, përveç rastit kur i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar.

3. Plotësimi i të dhënave në Regjistrin Kombëtar, kur në aktin e lindjes ka rubrika të paplotësuara, bëhet, sipas rastit, me vendim gjykate.

3/a. Kur në aktin e lindjes të mbajtur jashtë vendit është e paplotësuar rubrika e emrit, plotësimi i saj bëhet në përputhje me procedurën administrative, të përcaktuar me akt nënligjor të ministrit përgjegjës për gjendjen civile.

4. Kur data e vendi i lindjes nuk mund të përcaktohen, shënohen si të tilla koha e vendi i takimit të deklaruesit me nënën, e cila ka vdekur më pas, ose koha e vendi i gjetjes së fëmijës.

KREU VII

REGJISTRIMI I AKTIT TË MARTESËS

Neni 46

Forma e aktit të martesës

(hequr fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

1. Akti i martesës është procesverbali i mbajtur nga nëpunësi i zyrës së gjendjes civile në bashki, ku pasqyrohet vullneti i përbashkët i bashkëshortëve të ardhshëm, i shprehur në prani të nëpunësit të gjendjes civile, sipas përcaktimeve të Kodit të Familjes.

2. Kur nuk janë plotësuar kërkesat për shpalljen e martesës, ka vend për dyshime ose vihen re pengesa ligjore për lidhje martese apo parregullsi në dokumentet e identitetit të palëve,

ndërpriten veprimet. Kur është e mundur, bëhet verifikimi i menjëhershëm dhe veprimet vazhdojnë vetëm kur rrëzohen shkaqet që sollën ndërprerjen.

Neni 47

Mënyra e mbajtjes së aktit dhe dokumentacioni i kërkuar

(ndryshuar pika 6 me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

1. Akti i martesës nënshkruhet nga bashkëshortët, në prani të jo më pak se dy dëshmitarëve. Kur bashkëshortët nuk dinë ose nuk janë në gjendje fizike të nënshkruajnë, shkaku i mosnënshkrimit pasqyrohet në akt.

2. Martesa lidhet kur nëpunësi i gjendjes civile vërteton, pasi ka përfunduar procedura e shpalljes së martesës, sipas Kodit të Familjes, identitetin e secilit prej bashkëshortëve.

3. Martesa e shtetasit të huaj ose e personit pa shtetësi, që banon jashtë shtetit ose është banues i përkohshëm në Republikën e Shqipërisë, me shtetas shqiptar lidhet sipas dokumenteve të shtetit, shtetas i të cilit është ose ku ka banimin e përhershëm, të lëshuar jo më parë se tre muaj nga data që kërkohet të lidhet martesa, përveç rasteve kur ka mënyra dhe një afat tjetër, të përcaktuar në marrëveshje shumëpalëshe ose dypalëshe.

4. Për të huajt, të cilët kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë ose janë refugjatë, akti i martesës bazohet në dokumentet personale, të vërtetuara brenda 15 ditëve nga organi përkatës shqiptar ose drejtpërdrejt nga të dhënat e këtij organi.

5. Shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, me qëndrim të përkohshëm në Republikën e Shqipërisë, mund të lidhin martesë ndërmjet tyre në një zyrë të gjendjes civile, me dëshirën e vet. Gjithashtu, martesa mund të lidhet kur njëri ose të dy janë të burgosur në Republikën e Shqipërisë, kur në vendin e tyre nuk mund të lidhin martesë ose nuk mund të shkohet për shkaqe objektive.

6. Rregullat dhe procedura për lidhjen e martesës dhe dokumentacioni që duhet të mbahet nga gjendja civile për lidhjen e martesës, si dhe për ndryshimin e mbiemrit, kur ndodh për shkak të martesës, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për gjendjen civile.

Neni 48

Përmbajtja e aktit të martesës

Në aktin e martesës pasqyrohen treguesit e mëposhtëm:

- a) zyra e gjendjes civile, ku kryhet akti i martesës;
- b) numri dhe data e mbajtjes së aktit të martesës;
- c) numri dhe data e shpalljes së martesës;
- ç) numri dhe data e vendimit të gjykatës;
- d) vendi i lidhjes së martesës dhe ora;
- dh) identiteti, numri personal të secilit prej bashkëshortëve të ardhshëm;
- e) vendbanimi /vendqëndrimi para martesës;
- ë) vendbanimi pas martesës;
- f) mbiemri që do të mbajë pas lidhjes së martesës secili nga bashkëshortët;
- g) njohja e atësisë ose amësisë së fëmijëve të bashkëshortëve, të lindur para martesës;
- gj) regjimi pasuror martesor i bashkëshortëve;
- h) numri personal emri, mbiemri dhe vendbanimi i dëshmitarëve;
- i) numri personal, emri, mbiemri i përkthyesit;
- j) emri, mbiemri dhe nënshkrimi i nëpunësit të gjendjes civile.

Neni 49

Vërtetimi i martesës

Fakti juridik i martesës lind dhe vërtetohet me dokumentin që hartohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi e që pasqyron vullnetin e personave, në prani të nëpunësit të gjendjes civile dhe të dy dëshmitarëve.

Neni 50

(ndryshuar me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

1. Nëpunësi i gjendjes civile kryen veprimet për mbajtjen e aktit të martesës në Regjistrin Kombëtar dhe përditëson të dhënat, në përputhje me dispozitat e Kodit të Familjes.

2. Transkriptimi i të dhënave referuese të aktit të martesës, që shtetasit shqiptarë kanë lidhur në zyrat e gjendjes civile në vende të huaja, në Regjistrin Kombëtar bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Shtetasi, që pretendon se i është cenuar një e drejtë nga pasaktësi në aktin e martesës, mund t'i drejtohet gjykatës kompetente, sipas legjislacionit në fuqi, për të rivendosur të drejtën e cenuar.

KREU VIII

REGJISTRIMI I AKTIT TË VDEKJES

Neni 51

(ndryshuar me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016; shtuar pika 3 me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

1. Akti i vdekjes është dokumenti që vërteton ligjërisht vdekjen e shtetasit dhe mbahet për çdo të vdekur. Ky akt nënshkruhet nga nëpunësi i gjendjes civile dhe deklaruesi, pasi të jetë administruar dokumenti “skedë vdekjeje”, i lëshuar nga institucionet e autorizuar shëndetësore, që kanë të drejtë të vërtetojnë këtë fakt.

2. Akti i vdekjes përmban:

- a) zyrën e gjendjes civile në bashki/njësi administrative ku mbahet akti i vdekjes;
- b) numrin dhe datën e mbajtjes së aktit të vdekjes;
- c) vendin dhe orën e vdekjes;
- ç) shkakun e vdekjes, të përcaktuar sipas dokumentit shëndetësor;
- d) identitetin dhe numrin personal të të vdekurit ose konfirmimin e të ngarkuarit të posaçëm, për kufomat e gjetura, që nuk mund të identifikohen;
- dh) numrin personal, emrin dhe mbiemrin e mjekut ose të ekspertit mjeko-ligjor, që ka plotësuar skedën e vdekjes;
- e) të dhënat referuese të njoftimit përkatës të institucionit të prokurorisë, që autorizon kryerjen e veprimeve për raste të përcaktuara në këtë ligj;
- ë) emrin, mbiemrin e nëpunësit të zyrës së gjendjes civile.

3. Rregullat dhe procedurat për regjistrimin e fëmijëve, që lindin të vdekur, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për gjendjen civile.

Neni 52

Deklarimi i vdekjes

(ndryshuar pika 1, 3 dhe shtuar pika 3/1 me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016, ndryshuar shëronja “c”, shtuar një fjali në fund të pikës 4 dhe shfuqizuar pika 9 me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

1. Deklarimi i vdekjes bëhet nga:

- a) çdo pjesëtar madhor i familjes;
- b) nga persona të afërt të familjes;
- c) në rastin kur ka përfunduar afati i parashikuar në pikën 3, të këtij neni, dhe nuk është bërë

deklarimi i vdekjes nga subjektet e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj pike, i ngarkuari i posaçëm i bashkisë bën deklarin në zyrën e gjendjes civile, ku shtetasi që ka ndërruar jetë ka pasur vendbanimin ose vendqëndrimin në momentin e vdekjes.

2. Deklarimet janë të vlefshme, kur shoqërohen me raport mjekësor.

3. Afati për deklarin në zyrën e gjendjes civile është 10 ditë, nga data e vdekjes ose gjetja e kufomës, për vdekjet brenda vendit, dhe 90 ditë, nga data e vdekjes, për vdekjet jashtë vendit.

3/1. Për vdekjen aksidentale, afati i deklarimit në zyrën e gjendjes civile është 10 ditë nga lëshimi i lejes nga prokurori, e cila paraqitet në zyrën e gjendjes civile nga subjektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

4. Drejtuesit e spitaleve, të reparteve ushtarake, të burgjeve, të reparteve të riedukimit dhe të institucioneve të tjera detyrohen të njoftojnë me shkresë zyrën e gjendjes civile më të afërt, brenda 5 ditëve, për vdekjet e ndodhura në institucionet e tyre. Rregulla të hollësishme për zbatimin e kësaj pike përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për gjendjen civile me ministrat që mbulojnë institucionet e përmendura në këtë pikë.

5. Kur vdekja ndodh ditët e pushimeve dhe nuk mund të sigurohet leja e varrimit, përgjegjësi i shërbimit të varrimit kërkon dokumentet, që vërtetojnë vdekjen dhe me këto dokumente bën deklarin e vdekjes në zyrën e gjendjes civile, në ditën e parë të punës.

6. Me deklarin e vdekjes, zyra e gjendjes civile jep edhe lejen e varrimit.

7. Në fshatra, në juridiksionin e komunave, që nuk kanë zyrë të gjendjes civile, lejen për varrimin e jep kryeplaku i fshatit. Në këtë rast, kryeplaku, pasi ka administruar dokumentet, që vërtetojnë vdekjen, është i detyruar që, brenda pesë ditëve, të njoftojë zyrën e gjendjes civile, ku janë të dhënat e shtetasit, për regjistrimin e aktit të vdekjes.

8. Zyra e gjendjes civile, kur merr njoftimin për vdekje, sipas pikës 4 të këtij neni dhe për ato raste kur nuk paraqiten të afërm të viktimës për të bërë deklarin, kërkon të bëhet verifikimi nga përfaqësuesit e pushtetit vendor. Në rast se konfirmohet vdekja, atëherë mban aktin e vdekjes, për të cilin duhet të firmosin, sipas rastit, përfaqësues të pushtetit vendor, kryeplaku i fshatit, administratori i lagjes, ose përfaqësuesi i shërbimit të varrimit, si palë e interesuar.

9. Shfuqizuar.

10. DPGJC-ja është detyruar që për çdo muaj të gjenerojë nga Regjistri Kombëtar listën e shtetasve që kanë mbushur moshën 100 vjeç dhe për çdo datë 5 të muajit pasardhës shpërndan listën, sipas zyrës së gjendjes civile. Zyra e gjendjes civile, në bashkëpunim me përfaqësuesit e pushtetit vendor, bën verifikimin rast pas rasti, sipas procedurës së miratuar nga ministri përgjegjës për gjendjen civile.

Neni 53

Vërtetimi i faktit juridik të vdekjes

(ndryshuar fjalia e dytë e pikës 1 me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

1. Shtetasi vlerësohet se ka vdekur në fakt, kur vërtetohet me raport mjekësor, ku saktësohen identiteti, fakti, koha, vendi e shkaku i vdekjes së tij. Shtetasi vlerësohet se ka vdekur në fakt edhe në rastet kur me vendim gjyqësor të shkallës së parë vërtetohet fakti juridik i vdekjes. Kërkesën për vërtetimin e faktit juridik të vdekjes kanë të drejtë ta bëjnë subjektet e përcaktuara në pikën 1, të nenit 52, të këtij ligji.

2. Kur kufoma nuk mund të identifikohet, vihen re shenja ose dyshohet të jetë vdekje e dhunshme, raporti lëshohet nga eksperti mjeko-ligjor. Në këto raste, pavarësisht nga fillimi ose jo i ndjekjes penale, veprimet në gjendjen civile kryhen vetëm me lejen e prokurorit.

3. Në raportin mjekësor shkaqet e vdekjes klasifikohen në shkaqe shëndetësore, aksidentale ose kriminale.

4. Vendimi i gjykatës, që shpall shtetasin të vdekur, regjistrohet në Regjistrin Kombëtar e/ regjistrin themeltar (arkivi), pa u mbajtur akti i vdekjes.

5. Vdekjet jashtë shtetit vërtetohen sipas ligjit të vendit, ku ka ndodhur vdekja, me përjashtim të rasteve kur vdekja ndodh në territorin e misionëve diplomatike dhe posteve konsullore, në avion apo në anije shqiptare, në udhëtim, në zonat ndërkombëtare, për të cilat zbatohet ky ligj.

Neni 54

Vërtetimi i vdekjes

Vdekja vërtetohet nga mjeku i zonës përkatëse, ku ka ndodhur vdekja (mjekë, qendër shëndetësore, spital, urgjencë etj.). Për vdekjet e shkaktuara nga përdorimi i dhunës ose për vdekjet e dyshimta, si dhe për vdekjet në vendet e vuajtjes së dënimeve me burgim, vërtetimi është i vlefshëm vetëm kur lëshohet nga eksperti mjeko-ligjor dhe është nënshkruar edhe nga prokurori.

Neni 55

Pavlefshmëria e aktit të vdekjes

1. Akti i vdekjes është absolutisht i pavlefshëm kur personi, në fakt, nuk ka vdekur, gjë që vërtetohet me paraqitjen e tij fizike ose ekzistencën pas datës së aktit të vdekjes, në çdo rast me mungesë kufome apo kufomë të një personi tjetër.

2. Akti i vdekjes është i pavlefshëm kur ka vdekur një person tjetër nga ai që përmban akti dhe, në këtë rast, është i detyrueshëm të mbahet akt i veçantë për të vdekurin në fakt.

3. Akti i vdekjes shpallet relativisht i pavlefshëm kur nuk i përgjigjet realitetit, për sa i përket kohës, shkakut e vendit të vdekjes.

4. Pavlefshmëria, sipas pikës 1 të këtij neni, konstatohet nga gjykata, pas kërkesës së paraqitur, në çdo kohë, nga personi, për të cilin është mbajtur akti i vdekjes. Kur personi është i mitur, i është hequr apo kufizuar zotësia për të vepruar ose nuk është në gjendje mendore apo fizike, këtë të drejtë e kanë përfaqësuesit ligjorë ose kujdestarët e tij dhe, kur nuk ka të tillë apo kur kjo e drejtë nuk ushtrohet prej tyre, të drejtën e ka edhe prokurori.

5. Në rastin e pikës 2 të këtij neni, përveç personit, që rezulton i gjallë, pavlefshmëria kërkohet edhe nga personat, të cilët kanë pasojat juridike nga mungesa e aktit të vdekurit në fakt. Kur këta janë të mitur, u është hequr zotësia për të vepruar ose nuk janë në gjendje mendore apo fizike dhe nuk paraqitet kërkesë nga përfaqësuesi ligjor apo kujdestari, ose kur nuk ka të tillë, si dhe kur pasojat rëndojnë mbi shtetin, kërkesa paraqitet nga prokurori.

6. Prokurori paraqet kërkesë edhe kur personi, që rezulton i gjallë, ndonëse i ka mundësitë, nuk bën kërkesë ose shmanget qëllimisht.

7. Në rastin e pikës 2 të këtij neni, kur nuk mund të përcaktohet identiteti i personit të vdekur realisht, çështja shqyrtohet më vete, duke bërë identifikimin ose jo, por, në çdo rast, duke mbajtur një akt tjetër vdekjeje.

8. Pavlefshmëria, sipas pikës 3 të këtij neni, kërkohet nga të interesuarit, që kanë zotësi juridike ose nga prokurori, kur pasojat rëndojnë mbi të miturit, personat madhorë, që u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, kur:

- a) kjo nuk ushtrohet nga përfaqësuesit ligjorë ose kujdestari;
- b) nuk ka të tillë;
- c) pasojat lidhen me shtetin.

9. Me shpalljen e pavlefshmërisë së aktit të vdekjes me vendim gjyqësor, shënimet në fletën familjare të regjistrit themeltar ose në Regjistrin Kombëtar anulohen ose ndryshohen dhe ky veprim pasqyrohet në rubrikën e vërejtjeve dhe në vetë aktin e vdekjes.

KREU IX

EMRI, MBIEMRI DHE NDRYSHIMI I TYRE

Neni 56

Emri e mbiemri

(Shfuqizuar pikat 4 dhe 5 me ligjin nr. 130/2013, datë 25.4.2013 (ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016, ndryshuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

1. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile, që ka detyrimin e mbajtjes së aktit të lindjes, pasi administron deklaratën e shkruar të personave të përcaktuar në nenin 40, të këtij ligji, lidhur me:

a) emrin që do t'i vendosin fëmijës së lindur, përveç emrave të klasifikuar të papërshtatshëm, sipas përcaktimeve të këtij ligji;

b) mbiemrin që do të mbajë fëmija, në përputhje me Kodin e Familjes, i pasqyron këta përbërës të gjendjes civile në aktin e lindjes.

2. Refuzimi i regjistrimit të emrit të caktuar mund të kundërshtohet në organet gjyqësore.

3. Kur prindërit nuk bien dakord, nëpunësi i gjendjes civile cakton një emër, me shënimin në kllapa "i përkohshëm", deri në zgjidhjen e konfliktit nga gjykata.

4. Shfuqizuar.

5. Shfuqizuar.

6. Mbiemri i fëmijës përcaktohet në bazë të procedurave të parashikuara në Kodin e Familjes.

7. Kur prindërit kanë vdekur apo nuk janë në gjendje fizike a mendore ose nuk gjenden, emri caktohet nga pjesëtarët e familjes, të afërmit e tjerë dhe, në mungesë të tyre, nga nëpunësi i gjendjes civile.

Neni 57

Rastet e ndryshimit të mbiemrit dhe të emrit

(Ndryshuar me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013)

1. Mbiemri mund të ndryshojë vetëm në rastet e mëposhtme:

a) sipas rasteve të parashikuara në Kodin e Familjes;

b) me kërkesë të personit të interesuar, sipas procedurës së parashikuar në nenet 57/1 deri në 57/10 të këtij ligji.

2. Emri mund të ndryshojë vetëm në rastet e mëposhtme:

a) sipas rasteve të parashikuara në Kodin e Familjes, në rastin e birësimi;

b) me kërkesë të personit të interesuar, sipas procedurës së parashikuar në nenet 57/1 deri në 57/10 të këtij ligji, brenda 1 viti nga mbushja e moshës madhore, dhe vetëm një herë, si dhe sipas nenit 45 të këtij ligji.

Neni 57/1

Procedura për ndryshimin e emrit dhe mbiemrit me kërkesë të personit të interesuar

(Shtuar me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013)

1. Me përjashtim të rastit të korigjimit të emrit/mbiemrit, çdo shtetas mund të kërkojë ndryshimin e emrit ose të mbiemrit pranë zyrës së gjendjes civile ku ka vendbanimin. Kërkesa duhet të përmbajë arsyen/shkakun e ndryshimit të emrit/mbiemrit dhe emrin/mbiemrin e ri që kërkohet të merret. Kërkesa paraqitet personalisht nga kërkuesi në zyrën e gjendjes civile përkatëse.

2. Kërkesa për ndryshimin e emrit të përkohshëm, të vendosur nga prindërit, mund të bëhet nga vetë personi brenda një viti nga data e mbushjes së moshës madhore. Në këtë rast kërkesa përmban datën dhe nënshkrimin e kërkuesit, i cili duhet të përcaktojë qartë emrin e përhershëm që kërkon të marrë.

3. Kërkesa për ndryshimin e emrit ose mbiemrit duhet të bëhet vetëm një herë dhe vetëm për shkaqe papërshtatshmërie. Kjo dispozitë nuk gjen zbatim në rastin e aplikimit të kërkesës për ndryshimin e emrit të përkohshëm, sipas pikës 2 të këtij neni.

Në asnjë rast nuk mund të kërkohet marrja e mbiemrave që u përkasin personave me rëndësi historike, apo të tillë që mund të çojnë në lajthim, lidhur me përkatësinë e familjeve të shquara në shkallë kombëtare apo të mirënjohura në bashkinë/komunën ku ka vendbanimin kërkuesi, të përcaktuara si të tilla sipas procedurës së përmendur në pikën 4 të këtij neni.

4. Ministri përgjegjës për gjendjen civile parashikon me udhëzim rregullat lidhur me përcaktueshmërinë e emrave/mbiemrave që konsiderohen të papërshtatshëm, si dhe listën me emra dhe mbiemra të personave që kanë rëndësi historike, familjeve të shquara në shkallë kombëtare apo të mirënjohura në bashkinë/komunën ku ka vendbanimin kërkuesi, së bashku me një listë, pasi merr paraprakisht mendimin e institucioneve të specializuara. Ky udhëzim është i detyrueshëm për zbatim nga zyrat e gjendjes civile, si dhe çdo organ tjetër shtetëror.

Neni 57/2

Dokumentet që i bashkëlidhen kërkesës

(Shtuar me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013)

Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

- a) vërtetimin e gjendjes gjyqësore/formularin e plotësuar të vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore;
- b) vërtetimin nga prokuroria se nuk është në ndjekje penale;
- c) vërtetimin nga gjykata se nuk është në proces gjyqësor;
- ç) kopjen e letërnjoftimit;
- d) certifikatën e lindjes dhe certifikatën e përbërjes familjare;
- dh) vërtetimin se nuk është marrë ndaj tij ndonjë urdhër dëbimi/largimi nga ndonjë shtet tjetër;
- e) vendimin gjyqësor, i njohur sipas legjislacionit shqiptar, në rast të ndryshimit të emrit apo mbiemrit në një vend tjetër, jashtë rasteve të parashikuara nga Kodi i Familjes.

Neni 57/3

Rastet kur ndalohet ndryshimi i emrit dhe mbiemrit

(Shtuar me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013)

Emri dhe mbiemri nuk ndryshohen në rastet kur:

- a) shtetasi është në proces gjyqësor ose nuk ka mbaruar ndjekja penale;
- b) vërtetohet se ndaj shtetasit është marrë urdhër dëbimi/largimi nga ndonjë shtet tjetër.

Neni 57/4

Procedura për shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës

(Shtuar me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013)

1. Kërkesa për ndryshimin e emrit/mbiemrit i paraqitet përgjegjësit të zyrës së gjendjes civile, ku kërkuesi ka vendbanimin. Tarifat për paraqitjen e kërkesës përcaktohet me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për gjendjen civile dhe të Ministrit të Financave dhe parapaguhet nga kërkuesi me depozitimin e kërkesës.

2. Përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile formon fashikullin e kërkesës me dokumentet përkatëse dhe, pasi ka verifikuar nëse ka shënime të mëparshme në regjistrin e gjendjes civile, brenda 60 ditëve, e përcjell fashikullin pranë prefektit të qarkut, nën juridiksionin e të cilit ndodhet zyra e gjendjes civile, së bashku me mendimin e tij lidhur me plotësimin e dokumentacionit dhe verifikimin paraprak të arsyeve të kërkesës së paraqitur.

3. Prefekti, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe kërkesës, kryen këto verifikime:
- a) pasjen ose mospasjen e juridiksionit;
 - b) hetimin për praninë e shkaqeve që legjitimojnë kërkesën dhe legjitimimin e kërkuarit, sipas nenit 57 të këtij ligji;
 - c) respektimin e procedurave dhe të afateve kohore, brenda të cilave duhej të ishte paraqitur kërkesa;
 - ç) vlerësimin e arsyeve të kërkesës;
 - d) marrjen e dokumenteve zyrtare, provave të nevojshme apo informacionit të nevojshëm për trajtimin e kërkesës.

Prefekti, kur çmon se janë përmbushur kushtet dhe procedurat, sipas këtij ligji, urdhëron afishimin e shpalljes të kërkesës në zyrën e gjendjes civile ku është paraqitur kërkesa, pranë vendbanimit të kërkuarit, si dhe në dy prej gazetave për një periudhë prej 15 ditësh, si dhe/ose në Fletoren Zyrtare. Shpallja duhet t'u njoftohet personave të interesuar për ndryshimin e emrit/mbiemrit të kërkuarit apo të atyre personave që mund të preken nga ndryshimi i kërkuar. Forma dhe përmbajtja e shpalljes përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për gjendjen civile, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile. Tarifatat për afishimin e shpalljes përcaktohen me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për gjendjen civile dhe të Ministrit të Financave dhe parapagohen nga kërkuari përpara se të bëhet afishimi i shpalljes.

4. Prefekti, kur çmon se kërkesa nuk plotëson dokumentacionin shoqërues apo elementet formale të saj, cakton një afat jo më të shkurtër se 30 ditë për plotësimin e kërkesës, duke njoftuar kërkuarin dhe zyrën e gjendjes civile, ku ai ka vendbanimin. Nëse brenda këtij afati kërkuari nuk plotëson të metat e kërkesës, prefekti vendos për deklarimin e braktisjes së procedurës dhe arkivimin e kërkesës. Në këtë rast kërkesa nuk evidentohet në shënimet e gjendjes civile.

Neni 57/5

Kundërshtimi i të tretëve

(Shtuar me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013)

1. Çdo person i tretë mund të kundërshtojë kërkesën për marrjen e emrit apo mbiemrit të ri, në rast se mund të preken interesat e tij, brenda afatit prej 45 ditësh, nga dita e fundit e afishimit të shpalljes.

2. Kundërshtimi bëhet me kërkesë me shkrim dhe duhet të depozitohet pranë prefektit ose në zyrën e gjendjes civile, ku kërkuari ka vendbanimin. Në këtë rast, kërkesa i përcillet pa vonesë prefektit të qarkut ku bën pjesë zyra e gjendjes civile.

Neni 57/6

Vendimi për kërkesën

(Shtuar me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013)

1. Me kalimin e afatit të parashikuar për kundërshtimin e të tretëve, pas verifikimit të ligjshmërisë së procedurës së parashikuar, si dhe vlerësimit të kundërshtimeve që mund të jenë paraqitur, prefekti nxjerr mendim të arsyetuar për themelin e kërkesës për ndryshimin, sipas rastit, të emrit apo mbiemrit, duke i propozuar Komisionit Kombëtar për vlerësimin përfundimtar të kërkesës për ndryshimin e emrave apo të mbiemrave pranimin apo refuzimin e ndryshimit.

Mendimi i prefektit për kërkesën për ndryshimin e emrit apo mbiemrit, së bashku me fashikullin e kërkesës, i përcillet për shqyrtim dhe miratim Komisionit Kombëtar pranë ministrit përgjegjës për punët e brendshme, i cili vendos për kërkesën, në përputhje me kushtet e parashikuara nga ky ligj dhe në bazë të procedurave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

2. Nëse prefekti vlerëson se ndryshimi i kërkuar ka të bëjë me mbiemra të personave që kanë rëndësi historike, familjeve të shquara apo të mirënjohura në juridiksionin e tij, që nuk janë në

listën e miratuar me udhëzim, përpara përcjelljes së kërkesës pranë Komisionit Kombëtar, ai ka të drejtë t'i kërkojë mendim këshillit komunal ose atij bashkiak apo institucioneve të tjera publike të specializuara të fushës për marrjen e emrave apo mbiemrave që kërkohen të merren nga kërkuesi. Mendimi i këshillit komunal/bashkiak, apo i institucionit të specializuar, përfshihet në fashikullin që shoqëron kërkesën. Nëse këshilli komunal/bashkiak apo institucioni i specializuar nuk shprehen brenda afatit 90 ditor, ky fakt konsiderohet si mos kundërshtim i heshtur i kërkesës dhe evidentohet në procesverbal nga ana e prefektit.

3. Me qëllim vlerësimin përfundimtar të kërkesave për ndryshimin e emrave/mbiemrave, pranë ministrisë përgjegjëse për punët e brendshme, krijohet Komisioni Kombëtar për vlerësimin përfundimtar të kërkesave për ndryshimin e emrave apo mbiemrave. Përbërja dhe rregullat për funksionimin e Komisionit Kombëtar për vlerësimin përfundimtar të kërkesave për ndryshimin e emrave apo mbiemrave, si dhe masa e shpërblimit të anëtarëve të komisionit miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për punët e brendshme.

4. Pas përcjelljes së kërkesës dhe fashikullit shoqërues në Komisionin Kombëtar për vlerësimin përfundimtar të kërkesave për ndryshimin e emrave apo mbiemrave, ky i fundit, në përfundim të procedurës administrative për marrjen e të dhënave të nevojshme, shprehet me vendim përfundimtar për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për ndryshimin e emrit/mbiemrit.

5. Vendimi i komisionit, i arsyetuar, i njoftohet kërkuesit dhe personave të interesuar, prefektit, si dhe zyrës së gjendjes civile përkatëse për veprim, sipas rastit, si dhe për mbajtjen e shënimeve përkatëse në regjistër.

Neni 57/7

Kërkesa për korrigjimin e emrit dhe mbiemrit

(Shtuar me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013)

Çdo person, që ka interes për të korrigjuar emrin/mbiemrin e vet, për shkak të një gabimi të provuar material, të bërë gjatë transkriptimit të akteve të gjendjes civile, mund të paraqesë kërkesë pranë zyrës së gjendjes civile ku ka vendbanimin.

Neni 57/8

Dokumentet që i bashkëlidhen kërkesës për korrigjim material

(Shtuar me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013)

Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

- a) kopje të aktit të lindjes;
- b) çdo dokument tjetër që provon gabimin.

Neni 57/9

Procedura për shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës

(Shtuar me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013)

1. Në rastin e gabimeve materiale të provuara në një akt të gjendjes civile, personi i interesuar apo pjesëtarët e familjarët që preken nga ai akt, mund të kërkojnë ndreqjen e gabimit të ndodhur, kur provojnë gabimin material gjatë kryerjes së veprimeve në Regjistrin Kombëtar. Nëpunësi i gjendjes civile, pas pranimit të kërkesës dhe dokumenteve shoqëruese, ia përcjell atë për vendim Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile, së bashku me një mendim mbi themelin e saj. Vendimi i drejtorit i komunikohet prefektit të qarkut përkatës dhe ky i fundit ka të drejtë t'ia njoftojë atë Komisionit Kombëtar.

2. Rregullat për shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës për korrigjim miratohen me urdhër të ministrit.

Neni 57/10

Efektet e ndryshimit të emrit dhe mbiemrit të ri

(Shtuar me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013)

Pas miratimit të kërkesës së shtetasit, ndryshimi i emrit dhe i mbiemrit pasqyrohet në Regjistrin Kombëtar. Në procesverbalin, që mbahet në këtë rast, pasqyrohen përbërësit e gjendjes civile të shtetasit, shkaku i ndryshimit, si dhe emri e mbiemri i ndryshuar.

Procesverbali nënshkruhet nga kërkuesi, nga të gjithë pjesëtarët madhorë të familjes, të cilët e kanë përbërës të tyre emrin ose mbiemrin, kur e pranojnë ndryshimin, nga nëpunësi i gjendjes civile dhe përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile. Emri e mbiemri i ndryshuar, si dhe numri e data e procesverbalit pasqyrohen në Regjistrin Kombëtar.

Rregullat dhe procedurat për pasqyrimin e ndryshimit të emrit/mbiemrit në Regjistrin Kombëtar përcaktohen nga ministri përgjegjës për shërbimin e gjendjes civile.

KREU X

**GJENDJA CIVILE E SHTETASVE TË HUAJ DHE
E PERSONAVE PA SHTETËSI**

(Ndryshuar me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013)

Neni 58

Kombësia

(Shfuqizuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 1.12.2011)

Neni 59

Gjendja civile e shtetasve të huaj dhe e personave pa shtetësi

1. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi, me banim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, si edhe shtetasit e huaj, që kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë, gëzojnë të gjitha të drejtat, sipas këtij ligji, me përjashtim të të drejtave, që lidhen ngushtë me shtetësinë shqiptare dhe të veçorive në mënyrën e dokumentimit.

2. Gjendja civile e shtetasit të huaj me banim të përkohshëm/të përhershëm në Republikën e Shqipërisë përcaktohet në dokumentet e shtetit përkatës, ndërsa ajo e personit pa shtetësi, në dokumentet e shtetit ku ka lindur ose prej nga ka ardhur. Gjendja civile e shtetasit të huaj, që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë vërtetohet nga të dhënat, që ka organi përkatës administrativ për refugjatët.

3. Shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, me banim të përkohshëm/të përhershëm, vizitorë ose që janë tranzit në Shqipëri, kanë të drejtë që, nëpërmjet shërbimit të gjendjes civile, të evidentojnë dhe të vërtetojnë faktet juridike të tyre, të ndodhura në territorin e Republikës së Shqipërisë, sikurse çdo shtetas shqiptar, përveçse kur ka pengesë ose një procedurë të veçantë, të përcaktuar me ligj apo marrëveshje ndërkombëtare.

KREU XI

SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE

Neni 60

Natyra dhe funksioni

(ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016, bequr fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

1. Shërbimi i gjendjes civile është shërbim unik shtetëror. Ky shërbim, në kuptim të këtij ligji, ushtrohet si funksion i deleguar edhe nga organet e qeverisjes vendore. Ai plotëson dhe

përditëson Regjistrin Kombëtar, mban aktet e gjendjes civile, lëshon certifikata, sipas përcaktimeve të këtij ligji, si dhe kryen shërbime të tjera, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Shërbimi i gjendjes civile, krahas detyrave të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, i jep informacion subjekteve të përcaktuar nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, mbi bazën e dokumentacionit që administrojnë, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, kundrejt tarifës që përcaktohet, sipas parashikimit të nenit 73 të këtij ligji.

Neni 61

(ndryshuar me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016 bequr fjalë në shkronjën "c" të pikës 1 me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018; ndryshuar togfjalësh në pikën 2 dhe shfuqizuar pikat 3 dhe 4 me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

1. Shërbimi Shtetëror i Gjendjes Civile organizohet, si më poshtë vijon:

- a) Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
- b) zyrat e arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut;
- c) zyrat e gjendjes civile në bashki;
- ç) shërbimi i gjendjes civile në misionet diplomatike dhe postet konsullore shqiptare.

Shërbimi i gjendjes civile në misionet diplomatike dhe postet konsullore shqiptare funksionon në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Veprimet e nëpunësve të autorizuar e të trajnuar në Regjistrin Kombëtar, në postet konsullore, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për shërbimin e gjendjes civile dhe të Ministrit të Punëve të Jashtme.

2. Shërbimi i gjendjes civile mund të ofrohet, në mënyrë të kufizuar, edhe në institucione të tjera shtetërore, të përcaktuara nga legjislacioni përkatës.

3. Shfuqizuar.

4. Shfuqizuar.

Neni 62

Struktura dhe organika

(bequr fjalë me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

Struktura, organika dhe numri i nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile në bashki dhe në zyrat e arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 63

Buxheti

(bequr fjalë në pikën 3 me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

1. Të ardhurat që sigurohen nga shërbimi i gjendjes civile duhet të përdoren në përputhje me aktet e Këshillit të Ministrave që rregullojnë përdorimin dhe administrimin e të ardhurave që krijohen nga institucionet buxhetore.

2. Buxheti i shërbimit të gjendjes civile është program më vete, brenda buxhetit të miratuar për Ministrinë e Brendshme.

3. Bashkitë, në përputhje me objektivin e tyre, mund të parashikojnë dhe kryejnë shpenzime, operative ose kapitale, shtesë, për përmirësimin e shërbimit të zyrës së gjendjes civile.

Neni 64

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile

1. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile është organi më i lartë i shërbimit të gjendjes civile.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile dhe nëpunësit e Drejtorisë së Përgjithshme të

Gjendjes Civile gëzojnë statusin e nëpunësit civil.

Neni 64/1

Marrëdhënia e punës e nëpunësit të shërbimit të gjendjes civile

(shtuar me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

Marrëdhënia e punës e nëpunësit të shërbimit të gjendjes civile në bashki dhe në zyrat e arkivit të gjendjes civile, pranë prefektit të qarkut, rregullohet sipas dispozitave të Kodit të Punës.

Neni 65

Detyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile

(bequr fjalë në shkronjat "d" dhe "g" dhe shfuqizuar shkronja "c" me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile kryen këto detyra:

- a) I propozon ministrit projektaktet në zbatim të ligjit.
- b) Harton dhe i propozon për miratim ministrit treguesit e cilësisë së shërbimit, metodikat dhe rregulloret për funksionimin e zyrave të shërbimit të gjendjes civile.
- c) Shfuqizuar.
- ç) Harton programe dhe merr masa për zhvillimin e vazhdueshëm të sistemit të shërbimit të gjendjes civile.
- d) Bën drejtimin metodik dhe kontrollon veprimtarinë e zyrave të shërbimit të gjendjes civile në zyrat e gjendjes civile në degët e qarkut, bashki, si dhe në misionet diplomatike dhe postet konsullore.
- dh) Bashkëpunon me institucione dhe donatorë të interesuar për problemet e shërbimit të gjendjes civile dhe i paraqet ministrit për miratim projekt marrëveshje, në përputhje me procedurat e përcaktuara për këtë qëllim.
- e) Merr masa, harton dhe zbaton programe për kualifikimin dhe rekrutimin e nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile.
- ë) Propozon modelet e dokumenteve që mbahen dhe lëshohen nga zyrat e shërbimit të gjendjes civile, si dhe programet kompjuterike që përdor ky shërbim.
- f) Vendos kriteret profesionale që duhen plotësuar nga nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile, për pranimin e tyre në këtë shërbim.
- g) Kur vëren shkelje, i propozon kryetarit të bashkisë dhe prefektit të qarkut masa administrative për nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile. Masat e propozuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile janë të detyrueshme për zbatim nga kryetarët dhe prefekti i qarkut.
- gj) Zgjidh konfliktet për veprimet apo mosveprimet e zyrave të gjendjes civile, në ushtrim të funksioneve të tyre.

Neni 66

Emërimi dhe lrimi i nëpunësit në zyrën e arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut

(ndryshuar me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

Emërimi dhe lrimi nga detyra i nëpunësit në zyrën e arkivit të gjendjes civile, pranë prefektit të qarkut, bëhet nga prefekti i qarkut, me miratimin e drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile, sipas kriterëve të përcaktuara me urdhër të ministrit përgjegjës për shërbimin e gjendjes civile.

Neni 67

Detyrat e zyrave të arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut

(ndryshuar pika "b" me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016; shtuar shkronja "e" me ligjin nr.

56/2024, datë 6.6.2024)

Zyrat e arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut kanë këto detyra:

- a) zbatojnë metodikat e hartuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
- b) administrojnë arkivin e regjistrave dhe të akteve të gjendjes civile, nivel qendër qarku;
- c) lëshojnë certifikata të shërbimit të gjendjes civile, për dokumentet që administrojnë vetë zyra, me kërkesë të personit të interesuar ose të zyrës së gjendjes civile në bashki /komunë;
- ç) u japin të dhëna institucioneve shtetërore dhe personave juridikë privatë, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
- d) pranojnë dhe shpërndajnë në zyrat e gjendjes civile në bashki/komuna njoftimet, që vijnë nga institucionet e tjera shtetërore dhe anasjelltas;
- dh) kontrollojnë veprimtarinë e zyrave të gjendjes civile në bashki/komuna dhe u propozojnë organeve përkatëse marrjen e masave të nevojshme;
- e) raportojnë para prefektit dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile për veprimtarinë e degës së qarkut dhe të zyrave të gjendjes civile në bashki/komuna.
- ë) lëshojnë vërtetim ku konfirmohet fakti që është i njëjti person, kur, për shtetasit shqiptarë, nga një transkriptim në tjetrin ka gabime në një ose më shumë përbërës të gjendjes civile.

Neni 68

**Zyrat e gjendjes civile në bashki,
Buxheti**

(hequr fjalë në pikat 2 dhe 3 me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

1. Shërbimi i gjendjes civile ushtron funksionet në bashki.
2. Emërimi në detyrë i nëpunësit të zyrës së gjendjes civile bëhet nga kryetari i bashkisë, sipas kriterëve të vendosura nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.
3. Lirimi nga detyra i nëpunësit të zyrës së gjendjes civile bëhet nga kryetari i bashkisë, me miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile.

Neni 69

**Detyrat e zyrave të gjendjes civile në bashki,
njësi administrative**

(shtuar fjalë në shkronjën "a" dhe ndryshuar shkronja "db" me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

Zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi administrative kanë këto detyra:

- a) përditësojnë Regjistrin Kombëtar dhe ofrojnë shërbimin e gjendjes civile për shtetas që kanë vendbanimin brenda juridiksionit territorial të tyre;
- b) mbajnë aktet e lindjeve, të martesave dhe të vdekjeve;
- c) lëshojnë dokumentin e identitetit, certifikatat e lindjes, ato familjare, të martesës dhe të vdekjes, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
- ç) kryejnë veprime të shërbimit të gjendjes civile, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në fuqi;
- d) plotësojnë detyrimet e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore të institucioneve të tjera shtetërore dhe të subjekteve të interesuara;
- dh) informojnë kryetarin e bashkisë, si dhe zyrat e arkivit të gjendjes civile, pranë prefektit të qarkut, për veprimtarinë e tyre, sipas kërkesës së tyre.
- e) plotësojnë të gjitha detyrat, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 69/1

(shtuar me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

1. Dokumenti “certifikatë”, që sipas dispozitave të këtij ligji lëshohet sipas të dhënave të Regjistrit Kombëtar, nga zyra e gjendjes civile në njësi administrative, mund të lëshohet edhe nga zyra e gjendjes civile në bashki, në juridiksionin e së cilës ndodhet njësia.

2. Në rastin e ofrimit të shërbimit, sipas parashikimit të bërë në pikat 2 dhe 3, të nenit 61, të këtij ligji, dokumenti “certifikatë” lëshohet sipas të dhënave të Regjistrit Kombëtar, me nënshkrimin dhe/ose vulën elektronike të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.

Neni 70

(shfuqizuar me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

Neni 71

Detyrat e shërbimit të gjendjes civile në misione diplomatike dhe poste konsullore

(ndryshuar neni me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

1. Nëpunësit në misione diplomatike dhe poste konsullore kryejnë të njëjtat veprime si nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe trajnohen përpara fillimit të detyrës si nëpunësit e gjendjes civile.

2. Nëpunësit në misione diplomatike dhe poste konsullore, përgjegjës për shërbimin e gjendjes civile, administrojnë dokumentacionin dhe kryejnë veprime në Regjistrin Kombëtar për shtetasit shqiptarë me vendqëndrim jashtë Shqipërisë, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj dhe në dispozitat e tjera ligjore.

3. Veprimet, rregullat e administrimit dhe përcjelljes së dokumenteve në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile për shtetasit shqiptarë, të cilat kryhen nga nëpunësit në misione diplomatike dhe poste konsullore miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për gjendjen civile dhe ministrit përgjegjës për punët e jashtme.

Neni 72

Nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile

Të drejtat dhe përgjegjësitë për kryerjen e veprimeve në regjistrat e gjendjes civile, sipas këtij ligji, i kanë vetëm nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile, ndërsa për misionet diplomatike dhe postet konsullore, vetëm nëpunësit e trajnuar për këtë qëllim.

Neni 73

(ndryshuar me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

1. Informacionet që jepen nga shërbimi i gjendjes civile për subjektet private, të përcaktuara nga ky ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, kryhen me pagesë, sipas tarifave të miratuara me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për shërbimin e gjendjes civile dhe të Ministrit të Financave.

2. Të ardhurat e siguruar nga tarifat, sipas pikës 1, të këtij neni, derdhen 100 për qind në Buxhetin e Shtetit.

Neni 74

Kundërvajtjet administrative

(Ndryshuar shkronjat “a”, “b”, “c” të pikës 1, me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013, ndryshuar shkronja “a” dhe shtuar shkronja “ç” me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016, ndryshuar fjalë në shkronjën “a” dhe “b” me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018, shfuqizuar shkronja “ç” e pikës 1 me ligjin nr.130/2020, datë 22.10.2020; ndryshuar pikat 1 dhe 2 me ligjin nr. 56/2024, datë 6.6.2024)

1. Në kuptim të këtij ligji, shkeljet e përmendura më poshtë, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë:

a) shkelja ose mosrespektimi i dispozitave të parashikuara në nenin 52, pikat 5 dhe 7, dënohet me gjobë në masën nga 3 000 lekë deri në 5 000 lekë.

b) shkelja ose mosrespektimi i dispozitave të parashikuara në nenin 3, pika 1, nenin 41/1, pika 1, në nenin 52, pika 4, nenin 65, shkronja “g”, nenin 66 dhe në nenin 68, pikat 2 dhe 3, dënohet me gjobë në masën nga 10 000 lekë deri në 50 000 lekë.

2. Gjobat e parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 1 të këtij neni vendosen nga drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile. Kundër vendosjes së masës administrative me gjobë bëhet ankim brenda 30 (tridhjetë) ditëve pranë ministrit përgjegjës për gjendjen civile, i cili brenda 10 (dhjetë) ditëve duhet të shprehet për këtë masë. Kundër urdhrit të ministrit përgjegjës për gjendjen civile bëhet ankim në gjykatë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

3. Masat administrative të gjobës, të cilat nuk ankimohen brenda afatit, si dhe ato të cilat lihen në fuqi me vendim gjyqësor të formës së prerë, janë titull ekzekutiv dhe ngarkohen zyrat përmbarimore për ekzekutimin e tyre.

KREU XII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 75 Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr.8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar, si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 76 Nxjerrja e akteve nënligjore¹ (Ndryshuar me ligjin nr. 130/2013, datë 25.4.2013)

Ngarkohen Këshilli i Ministrave dhe ministri përgjegjës për gjendjen civile që të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të neneve 15 pika 4, 18 pikat 3 dhe 4, 20 pika 4, 22 pika 2, 24 pika 4, 25, 52 pika 10, 62 dhe 63 të këtij ligji.

Dispozita kalimtare (Shtuar me ligjin nr.130/2013, datë 25.4.2013)

Procedura për ndryshimin e emrit/mbiemrit, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojë të rregullohet sipas dispozitave ligjore në fuqi, në datën e paraqitjes së kërkesës.

Neni 24 Dispozitë kalimtare (Parashikuar me ligjin nr. 134/2016, datë 22.12.2016)

Gjoba e parashikuar për shkeljen ose mosrespektimin e dispozitës së përcaktuar në nenin 22, të këtij ligji, pezullohet për 6 muaj, nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

¹ Ligj nr. 56, datë 6.6.2024, i botuar në FZ. nr. 115, datë 5.7.2024, në nenin 22 “Nxjerrja e akteve nënligjore” shprehet ;

1.Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore të parashikuara në nenet 4 dhe 13 të këtij ligji.

2.Ngarkohet ministri përgjegjës për gjendjen civile që brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore të përcaktuara në nenet 14 dhe 15 të këtij ligji.

3. Ngarkohet ministri përgjegjës për gjendjen civile dhe ministri i Drejtësisë të miratojnë udhëzimin e përbashkët në zbatim të nenit 6 të këtij ligji.

4.Ngarkohet ministri përgjegjës për gjendjen civile dhe ministri përgjegjës për punët e jashtme të miratojnë udhëzimin e përbashkët në zbatim të nenit 19 të këtij ligji.

Dispozitë kalimtare
(Shtuar me ligjin nr. 69/2018, datë 11.10.2018)

Gjoha e parashikuar për shkeljen ose mosrespektimin e dispozitës së përcaktuar në shkronjën “ç”, të pikës 1, të nenit 74, të ligjit, pezullohet për 6 muaj, nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 77
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6180, datë 25.5.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**